

17 shkurt 2026,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 16.02.2026, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.26/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga KB Sigal Prishtina për anulimin e rezultatit të ndeshjes kundër KB Vëllaznimi, e zhvilluar më 14 shkurt 2026, si dhe për regjistrimin e ndeshjes me rezultat zyrtar 20–00 në favor të KB Sigal Prishtina.

II. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe në bazë të nenit 44.8 të Propozicioneve të Garave të FBK-së për sezonin 2025/2026, Komisioni i Garave HEDH POSHTË ankesën e KB Sigal Prishtina të datës 15.02.2026 si të papranueshme.

III. Mbetet në fuqi rezultati i arritur në fushën e lojës në ndeshjen KB Vëllaznimi – KB Sigal Prishtina, e zhvilluar më 14.02.2026.

IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit.

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr. 26/2025-26, Komisioni i Garave ka vlerësuar dhe konstatuar si në vijim:

(a) Komisioni i Garave fillimisht ka shqyrtuar nëse ankesa e paraqitur nga KB Sigal Prishtina hyn në rastet e lejuara për paraqitje sipas nenit 44.1 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore 2025–26.

(b) Neni 44.1 përcakton në mënyrë taksative (numerus clausus) se ankesë mund të paraqitet vetëm në rastet kur ekipi pretendon se është dëmtuar si pasojë e:

- 44.1.1 – gabimit në procesverbal, matje kohe ose kohë sulmi;
- 44.1.2 – vendimit për humbje të ndeshjes së pazhvilluar, anulimit, shtyrjes, mos-rifillimit apo mos-zhvillimit të ndeshjes;
- 44.1.3 – paraqitjes së lojtarit të peregjistruar apo të dënuar.

(c) Pretendimi i paraqitur nga KB Sigal Prishtina ka të bëjë me vazhdimin e ndeshjes kundër KB Vëllaznimi pas një incidenti që konsiston në hyrjen e një shikuesi në fushën e lojës dhe tentimin për sulm fizik ndaj gjyqtarit të ndeshjes.

(d) Një pretendim i tillë nuk përfshihet në asnjërën nga kategoritë e përcaktuara shprehimisht në nenin 44.1, dispozitë kjo me karakter të mbyllur, e cila nuk lejon zgjerim përmes interpretimit analog apo ekstensiv.

(e) Për rrjedhojë, Komisioni konstaton se ankesa është proceduralisht e papranueshme dhe, si e tillë, hidhet poshtë pa u shqyrtuar në themel (meritorisht).

Pa paragjykuar papranueshmërinë e ankesës, Komisioni i Garave, për hir të qartësisë juridike dhe plotësisë së arsyetimit, vlerëson se edhe në rast se ankesa do të konsiderohej e pranueshme, ajo do të refuzohej si e pabazuar për këto arsye:

(a) Neni 41.7.6 i Propozicioneve të Garave parashikon ndërprerjen e menjëhershme të ndeshjes vetëm në rast të realizimit të sulmit fizik ndaj personave zyrtarë.

(b) Nga provat e administruara dhe raportet zyrtare rezulton se:

- Ka pasur hyrje të paautorizuar të një personi në fushën e lojës;
- Ka pasur tentim për kontakt fizik me gjyqtarin;

- Nuk është realizuar sulm fizik në kuptimin e përmbushjes së elementit material të goditjes apo shkaktimit të lëndimit trupor.

(c) Në mungesë të realizimit të sulmit fizik, nuk janë përmbushur kushtet ligjore për aplikimin automatik të nenit 41.7.6.

(d) Për më tepër, sipas nenit 41.6 të Propozicioneve të Garave, gjyqtarët janë të pavarur në ushtrimin e funksionit të tyre dhe të obliguar që, nëse ekzistojnë kushte normale për zhvillimin e lojës, ta çojnë ndeshjen deri në përfundim.

(e) Nga raportet zyrtare të ndeshjes rezulton se:

- Gjyqtari ndaj të cilit është tentuar sulmi ka deklaruar se është në gjendje të vazhdojë detyrën;
- Ndeshja ka vazhduar pas rikthimit të rendit dhe sigurimit të kushteve normale;
- Nuk ka ekzistuar pamundësi objektive për vazhdimin e saj.

Në këto rrethana, vendimi i Gjyqtarit të Parë për vazhdimin e ndeshjes ka qenë në përputhje me nenin 41.6 dhe brenda kompetencës së tij funksionale e diskrecionale.

(f) Përtej çështjes së vlefshmërisë së rezultatit të ndeshjes, Komisioni i Garave potencon se është inicuar procedurë disiplinore ndaj personit përgjegjës, në përputhje me rregulloret dhe normat disiplinore të Federatës, duke garantuar trajtimin institucional të incidentit.


Si përfundim, duke qenë se ankesa e KB Sigal Prishtina nuk përmbush kushtet e nenit 44.1 të Propozicioneve të Garave, ajo hidhet poshtë si e papranueshme.

Edhe në analizë alternative, pretendimet e paraqitura nuk përbëjnë bazë për aplikimin e nenit 41.7.6, ndërsa vendimi i gjyqtarëve për vazhdimin e ndeshjes ka qenë i ligjshëm, proporcional dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të Propozicioneve të Garave.

Komisioni i Garave:

Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës**KËSHILLË
JURIDIKE:**

Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.